

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, si gjykatë civile e shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit Makifete Saliuka, kryetare dhe Kujtim Pasuli e Nenad Llaziq, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësve F.H., A.H.1., A.H.2. dhe të miturit M. e A.H.3., të përfaqësuar nga përfaqësuesja ligjore, të gjithë nga fshati ..., Komuna e Istogut, të cilët i përfaqëson me autorizim A.K., avokat në Prishtinë, me adresë ..., ..., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" në Prishtinë, me përfaqësuesen e autorizuar A.M., jur. i dipl., për kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega Istog, C.nr.152/2012, i datës 6.9.2013, në seancën e mbajtur me dt. 13.4.2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. VËRTETOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega Istog, C.nr.152/2012, i datës 6.9.2013, në pjesët që i referohen kompensimit të dëmit jomaterial për paditësit për dhembje e përjetuara shpirtërore për vdekjen e tre anëtarëve të ngushtë të familjes dhe dëmit material për shpenzimet e varrimit dhe ngritje të përmendoreve, në shumat e gjykuara.

II. NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega Istog, C.nr.152/2012, i datës 6.9.2013, duke iu pranuar paditësve shumat e zvogëluara si në vijim:

- **për F.:** për dhimbje fizike trupore – 8.000,00€, për shëmtim trupor të shkallës së mesme - 3.000,00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 32 % - 10.000,00 € dhe për kujdesin nga personi i tretë - 5.400,00 €, ndërsa kërkesëpadia e saj për kompensimin e fitimit të humbur në shumë prej 12.600,00 € - REFUZOHET.
- **për A.2.:** për dhimbje fizike trupore - 4.000,00 € dhe për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 5 % - 1.500,00 €,
- **për M.:** për dhimbje fizike trupore – 8.000,00 €, për shëmtim trupor të shkallës së mesme - 4.500,00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 25 % - 8.000,00 € dhe për kujdesin nga personi i tretë – 900,00 €. Ndërsa, kërkesëpadia e paditëses M. për rehabilitim klimatik-terapeutik REFUZOHET.

III. VËRTETOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega Istog, C.nr.152/2012, i datës 6.9.2013, në pjesët tjera, ku paditëseve iu janë pranuar shumat si në vijim: **F.s** - për frikë - 2.000,00 € dhe për ushqim të përforcuar - 1.200,00 €; **A.2.** - për frikë – 3.000,00 €, për kujdesin nga personi i tretë - 150,00 € dhe për ushqim të përforcuar - 150,00 €, dhe **M.** - për frikë - 3.000,00 €, për kujdesin nga personi i tretë – 900,00 €, për ushqim të përforcuar – 600,00 €.

IV. NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega Istog, C.nr.152/2012, i datës 6.9.2013, edhe në pjesën që i referohet mbajtjes së humbur të paditësve, ashtu që:

- paditësve për kohën kontestuese nga data 22.8.2011 deri me datë 30.6.2013, në emër të mbajtjes së humbur përkatësisht rentës - ju pranohet shuma prej 2.821,50€, ndërsa nga data

1.7.2013 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për këtë ju paguhen nga 273,72 € në muaj, e cila pagese do të bëhet më së largu deri me datën 5 të muajit në vijim,

- të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

V. REFUZOHET SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësve mbi shumat e gjykuara si në paragrafët e mësipërm të dispozitivit të këtij aktgjykimi (të shkallës së dytë).

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e goditur, e ka *MIRATUAR PJESËRISHT SI TË BAZUAR kërkesëpadinë e paditësve F.H., A.H.1., A.H.2., M. e A.H.3., të gjithë nga fshati ..., Komuna e Istogut, duke e DETYRUAR të paditurën Kompania e Sigurimeve "Kosova e Re" në Prishtinë, që të njëjtëve në emër të kompensimit të dëmit jo material për vdekjen tragjike të bashkëshortit - babait M.H., djalit - vllaut A.H.4., vajzës - motrës V.H., si dhe në emër të lëndimeve trupore të pësuarat për . A.2 dhe M., në aksidentin e komunikacionit që ka ndodhur me datën 2.9.2011, t'iu paguaj të njëjtëve:*

- për dhimbjet e pësuarat shpirtërore humbjen e bashkëshortit dhe fëmijëve, ti paguhen bashkëshortes dhe nënës **F.H.** - 36.000,00 €, ndërsa fëmijëve, përkatësisht vëllezërve dhe motrave **A.2., A.1. dhe A.3.it** - nga 18.000,00 €, secilit veç e veç.

- për shpenzimet e varrimit t'iu paguhet shuma prej 6.000,00 € dhe për ngritje të lapidarit - përmendores 4.500,00 €.

- në emër të rentës për mbajtjen e humbur - si rentë e kapitalizuar në shumë prej 31.637,70 € (sipas ekspertizës së aktuarit të autorizuar).

Në emër të kompensimit të dëmit për lëndimet e pësuarat në këtë aksident për paditëset **F., A.2. e M.**, janë gjykuar shumat si në vijim:

- **për F.:** për dhimbje fizike trupore - 13.500,00 €, për frikë - 2.000,00 €, për shëmtim trupor - 3.500,00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 32 % - 22.750,00 €, për kujdesin nga personi i tretë - 15.000,00 €, për ushqim të përforcuar - 1.200,00 €, dhe në emër të fitimit të humbur 12.600,00 €

- **për A.2.:** për dhimbje fizike trupore - 5.000,00 €, për frikë - 3.000,00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 5 % - 5.000,00 €, për kujdesin nga personi i tretë - 150,00 € dhe për ushqim të përforcuar - 150,00 €

- **për M.:** për dhimbje fizike trupore - 11.000,00 €, për frikë - 3.000,00 €, për shëmtim trupor - 6.500,00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 25 % - 20.000,00 €, për kujdesin nga personi i tretë - 900,00 €, për ushqim të përforcuar - 600,00 €, dhe për rehabilitim - 300,00 €.

- duke iu pranuar edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.847,00 €.

Ndërsa, REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve mbi shumat e gjykuara.

Paditësve iu pranohen edhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.1847,00 €.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke konsideruar se shumata e pranuar për të gjithë paditësit e për të gjitha format e dëmit janë tepër të larta dhe nuk përkojnë me kriteret e Kompanive të Sigurimit e as me praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, me propozim që ankesa e saj të pranohet ashtu që aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktgjykimit të goditur dhe shkresave të lëndës në pajtim me dispozitën e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës vërehet se, me datën 2.9.2011, në fshatin Dollc, Komuna e Klinës, pikërisht në udhëkryqin Gjakovë-Pejë-Prishtinë, ka ndodhë aksidenti i komunikacionit me fajin ekskluziv të drejtuesit të automjetit "Mercedes 124", me targa ..., I.N., ku si bashkudhëtar të tij kanë humbur jetën M., V. dhe A.H.4., ndërsa lëndime të rënda trupore kanë pësuar F., A.2. dhe M. H., të gjithë nga fshati ..., Komuna e Istogut. Ky automjet ka qenë i siguruar në kompaninë e paditur, ndërsa drejtuesi i tij I. N. është shpallë fajtor për vepër penale Rrezik i trafikut publik nga neni 297 paragrafi 5 lidhur me paragrafin 3 të KPK-së, me aktgjykimin penal të Gjykatës së Qarkut në Pejë, P.nr. 492/2011 i datës 28.12.2011, dhe është gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 vitesh.

Paditësit, F., A.1., A.2., M. e A.H.3., të mbijetuar nga ky aksident, me padinë e tyre të datës 16.7.2012, kanë kërkuar që t'iu bëhet kompensimi i dhimbjeve shpirtërore për vdekjen e bashkëshortit - babait të tyre M., dhe djalit - vëllait A.H.4., vajzës - motrës V.H., në aksidentin aktual me pasoja fatale, me tre anëtarë të vdekur të familjes, duke kërkuar edhe kompensimin e dëmit material dhe jo material për lëndimet të pësuar trupore për F., A.2. dhe M., përfshirë këtu edhe fitimin e humbur për kohën e kaluar dhe rentën për të ardhmen.

Gjykata e shkallës së parë, mbi bazën e gjendjes së vërtetuar faktike e duke u bazuar edhe në afërsinë familjare të paditësve me të ndjerët M., A.4. e V.H., dhe duke u bazuar në provat shkresore të cilat gjenden në këtë lëndë, përfshirë këtu edhe ekspertizat mjekësore të bëra nga ekspertet Dr. K.Z., neurokirurg, dhe Dr. F.B., ekspert i mjekësisë ligjore, lidhur me natyrën e lëndimeve të paditësve të mbijetuar dhe frikën e përjetuar, si dhe në ekspertizat financiare të bëra nga A.B., ecc.dipl. dhe aktuar i autorizuar, e ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve në shumata e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, me rastin e vlerësimit të ligjshmërisë dhe rregullsisë së këtij aktgjykimi, në këtë rast ku baza juridike e kërkesëpadisë së paditësve nuk është kontestuese, sepse se në mënyrë të padyshimtë është vërtetuar se aksidenti ku kanë pësuar paditësit ka ndodhur me fajin ekskluziv të të siguarit të të paditurës (*shih Aktgjykimin penal të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap.nr. 210/2012, i datës 18.7.2012*), në të cilin të ndjerët M. A.4. e V.H. bashkë me paditësit kanë qenë vetëm bashkudhëtarë, ka gjetur se gjykata e shkallës së

parë ka vepruar drejtë kur me zbatimin e nenit 154, 185 dhe 193 të LMD-së lidhur me nenin 321.2 të LPK-së, e ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve të mbijetuar, lidhur me kompensimin e dëmit material dhe jomaterial për dhimbjet shpirtërore që ata kanë përjetuar për shkak të vdekjes së tre anëtarëve të ngushtë të familjes, por për tre persona: M. - 49 vjeç në kohën e vdekjes, i lindur në vitin 1962, A.4. - 10 vjeç, i lindur në vitin 2001, dhe V. - 15 vjeç, e lindur në vitin 1996,

- *duke ia pranuar bashkëshortes dhe nënës F. - 36.000,00 €, ndërsa fëmijëve , përkatësisht vëllezërve dhe motrave A.2, A.1 dhe A.3.it - nga 18.000,00 €, secilit veç e veç - si shumë relativisht adekuate për dhimbjet shpirtërore që ata kanë pësuar si rezultat i humbjes së tre anëtarëve të ngushtë të familjes, e që paditësja F. - tani të ndjerin M. e ka pasur bashkëshort, ndërsa të ndjerin A.4. - djalë, ndërsa të ndjerën V. - vajzë, ndërsa paditësit A.2., A.1. dhe A.4., të ndjerin M. e kanë pasur babë ndërsa të ndjerin A.4. - vëlla e të ndjerën V. - motër, bashkë me shpenzimet e varrimit në shumë prej 6.000,00 € dhe për ngritje të përmendores shumë prej 4.500,00 €, ashtu siç figuron në paragrafin I, pika a) e dispozitivit të aktgjykimit të goditur, duke marrë parasysh se bëhet fjalë për tre të vdekur, ku dhimbja është e pa kompensueshme, dhe shpenzimet janë më të mëdha, si ato të varrimit ashtu edhe ato për ngritjen e përmendoreve për tre persona, e që shumat e pranuar janë në harmoni me kriteret e kompanive të sigurimit dhe praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, prandaj në këtë pjesë - **VËRTETOHET.***

Këto shuma përkojnë me dhimbjet shpirtërore të paditësve dhe realitetin sipas traditës që dominon në Kosovë dhe janë në pajtim me kriteret e përafërta të përcaktuara nga kompanitë e sigurimit si dhe me praktiken gjyqësore të krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë vendimin e vet lidhur me kërkesëpadinë tjetër të paditëseve F., A.2. dhe M., që ka të bëjë me kompensimin e dëmit për lëndimet e rënda trupore që ato kanë pësuar në aksidentin aktual, e ka bazuar në vlerësimin e bërë nga ekspertët mjekësor Dr.K.Z., neurokirurg dhe Dr. F.B., ekspert i mjekësisë ligjore, të cilët në shqyrtimin e datës 20.11.2012 janë deklaruar lidhur me natyrën e lëndimit që kanë pësuar paditëset e mbijetuara në këtë aksident - F., nëna (e lindur në vitin 1970) dhe dy vajzat e saj A.2. (e lindur në vitin 1992) dhe M. (e lindur në vitin 1994), të cilat i kanë cilësuar si lëndime të rënda trupore dhe me pasoja - të përshkruara në detaje si në procesverbalin e seancës së datës 20.11.2012, që duket edhe nga dokumentacioni mjekësor i paditëseve, i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Ekspertët mjekësor kanë vlerësuar dhembjet fizike të tre paditëseve, intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre, frikën, kohëzgjatjen dhe intensitetin e saj, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, zvogëlimin e aktivitetit punues, shëmtimin, nevojën për përkujdesjen e personit të tretë dhe për ushqim të përforcuar si dhe kohëzgjatjen e këtyre nevojave, sikurse edhe nevojën për rehabilitimin klimatik - fizioterapeutik.

Gjykata e Apelit, në seancën e kolegjit, ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike edhe lidhur me këtë kërkesë të paditëseve të lënduara rëndë, por që të drejtën materiale e ka zbatuar gabimisht në drejtim të shumave të gjykuara, si të larta e që nuk përkojnë me kriteret e kompanive të sigurimit në Kosovë dhe me praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, në çka edhe thirret e paditura në pretendimet e saj ankimore, gjë që është në kundërshtim me nenin 200 par. 2 të LMD-së, prandaj kjo gjykatë, gjë që paraqet shkak për ndryshimin e këtij aktgjykimi në kuptim të nenit 201 par. 1 pika d) të LPK-së, prandaj kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, të njëjtin në këtë pjesë e **NDRYSHON.** ashtu që paditëseve iu pranohen shumat e zvogëluara si në vijim:

- **për F.:** për dhimbje fizike trupore – 8.000,00€, për shëmtim trupor të shkallës së mesme - 3.000,00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 32 % - 10.000,00 € dhe për kujdesin nga personi i tretë - 5.400,00 €
- **për A.2.:** për dhimbje fizike trupore - 4.000,00 € dhe për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 5 % - 1.500,00 €,
- **për M.:** për dhimbje fizike trupore – 8.000,00 €, për shëmtim trupor të shkallës së mesme - 4.500,00 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për 25 % - 8.000,00 € dhe për kujdesin nga personi i tretë – 900,00 €. Ndërsa, në mungesë të provave materiale për rehabilitim klimatik –terapeutik, kërkesëpadia e paditëses M., e pranuar në shumën prej 300,00 € nga gjykata e shkallës së parë – në këtë pjesë refuzohet.

Këto shuma janë relativisht korrekte dhe në pajtueshmëri me të gjitha kriteret dhe pasojat e dëmshme për shëndetin e paditëseve, duke vlerësuar se me këtë shpërblim të dëmit do të zvogëlohen dhembjet shpirtërore të tyre për lëndimet e pësuar, duke marrë parasysh moshën e tyre të re, F. - 41 vjeç në kohën e aksidentimit, A.2. – 19 vjeç dhe M. – 17 vjeç.

Ndërsa kërkesëpadia e paditëses F. për kompensimin e fitimit të humbur në shumë prej 12.600,00 € - refuzohet ngase nuk dihet në çka konsiston, nuk është i arsyetuar dhe nuk është i bazuar në prova materiale.

Aktgjykimi i goditur **VERTETOHET** në pjesët tjera ku paditëseve iu janë pranuar shumat si në vijim:

- **F.s** - për frikë i është pranuar vetëm shuma prej 2.000,00 € dhe për ushqim të përforcuar vetëm - 1.200,00 €,
- **A.2.-** për frikë i është pranuar vetëm shuma prej 3.000,00 €, për kujdesin nga personi i tretë - 150,00 € dhe për ushqim të përforcuar - 150,00 €, dhe
- **për M.** - për frikë i është pranuar vetëm shuma prej 3.000,00 €, për kujdesin nga personi i tretë – 900,00 €, për ushqim të përforcuar – 600,00 €.

Kjo për faktin se në rastin konkret nuk ka fare ankesë të paditësve por vetëm të të paditurës e që në prani të këtij fakti aktgjykimi i shkallës së dytë nuk mund të jetë më i disfavourshëm për të paditurën në kuptim të nenit 203 të LPK-së, sikurse që vërtetohet edhe në pjesën që ka të bëjë me kërkesën aksesore të paditësve lidhur me pagesën e shpenzimeve e procedurës kontestimore të pranuar në shumën prej 1.847,00 € - për të njëjtën arsye.

Sa i përket rentës për mbajtjen e humbur - si rentë e kapitalizuar në shumën e pranuar prej 31.638,70 € (sipas ekspertizës së aktuarit të autorizuar), për paditësit F., A.1., A.2., M. e A.H.3., ky vendim është marrë nga gjykata e shkallës së parë, pa vlerësuar paraprakisht fare faktet që ndërliken me plotësimin e kushteve të parapara ligjore për pranimin e rentës së kapitalizuar, si pagesë e menjëhershme.

Me nenin 188 par. 2 të LMD-së (së vjetër), në fuqi në kohën kur ka lindur kontesti në mes të ndërgjyqësve, është paraparë si rregull se, renta (e cila ka për qëllim plotësimin e nevojave të përditshme), paguhet një muaj përpara e jo në një shumë, ndërsa renta e kapitalizuar, e cila është përjashtim, dhe për t'iu paguar menjëherë në shumën e tërësishme - duhet të plotësohen kushtet ligjore për këtë. Është dashur që në kuptim të nenit 188 par. 5 të LMD-së, kreditorët, në këtë rast paditësit, të kenë arsye serioze për ta kërkuar pagesën e menjëhershme në shumën e tërësishme, të kapitalizuar – gjë që në rastin konkret ata nuk i kanë argumentuar se

ekzistojnë, pasi që është fakt botërisht i njohur se e paditura nuk ka qenë në ndonjë procedurë eventuale të likuidimit e as nuk është subjekt jo stabil ekonomikisht, aq më tepër kur shihet qartë se ka munguar pëlqimi i paditurës për këtë. Në këtë situatë gjykata e shkallës së parë është dashur ta ketë parasysh interesin e dy palëve e jo vetëm njërës palë, siç ka ndodhur në rastin konkret, prandaj edhe pretendimet ankimore të të paditurës për këtë formë të kompensimit përkatësisht për rentë të kapitalizuar tregohen si të bazuara, prandaj plotësohen kushtet nga neni 201 par. 1 pika d) e LPK-së, që aktgjykimi i goditur të **NDRYSHOHET** edhe në këtë pjesë, ashtu që:

- paditësve për kohën kontestuese nga data 22.8.2011 deri me datë 30.6.2013, në emër të mbajtjes së humbur përkatësisht rentës - ju pranohet shuma prej 2.821,50€, ndërsa nga data 1.7.2013 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për këtë ju paguhen nga 273,72 € në muaj, e cila pagese do të bëhet më së largu deri me datën 5 të muajit në vijim.

Shuma e gjykuar është e bazuar në ekspertizat gjyqësore nga lëmi financiar të bëra nga A.B. Vecc. dipl. dhe aktuar i autorizuar, i cili ka llogaritur të ardhurat personale të të ndjerit M., sipas mesatares së pagave në Kosovë, për punëtorët e pakualifikuar, i cili ka pasur biznes privat të regjistruar, e që si veprimtari ka pasur shitblerjen e masës drunore (*shih Kontratën nr. APK-1840/05, e datës 17.6.2005 për licencimin e shfrytëzimit të masës drunore të lidhur në mes të Ministrisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe të ndjerit M.H.*)

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes së kësaj kërkesëpadie të paditësve ka pasur parasysh rrethanat e kësaj familje, ku i ndjeri M. ka qenë i vetmi mbajtës i familjes, ndërsa paditësja bashkëshortja e tij F., amvise, dy vajzat A.2. e M., studente aso kohe dhe djali A.4. ende nuk ka qenë 18 vjeç, i lindur me datë 26.3.1998 – në kohën kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur lidhur me kërkesëpadinë e tyre.

Vendimi i goditur nuk përmban shkelje në të cilat thirret në pretendimet e saj ankimore kompania e paditur, e as shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Për arsyet e paraqitura si më lart, Gjykata e Apelit në pajtim me dispozitën e nenit 201 par. 1 pika d) lidhur me nenin 195 par. 1 pika e) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT NE PRISHTINE
AC.nr. 4910/2016, datë 13.4.2017

KRYETARJA E KOLEGJIT-GJYKATËSJA,
Makifete Saliuka